

GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

PKR 56/13

05 dhjetor 2013

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

Në emër të popullit

Gjykata Themelore e Gjilanit, në trupin gjykues të përbërë nga:

Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant, si kryetare e trupit gjykues,

Gjyqtari Behar Ymeri dhe Gjyqtari Hasan Sadiku, si anëtarë të trupit gjykues,

Me proces-mbajtësen Christine Sengl, në lëndën penale kundër të pandehurve:

1. A. K., shqiptar i Kosovës,
2. I. P., shqiptar i Kosovës,
3. B. S., shqiptar i Kosovës,
4. H. M., shqiptar i Kosovës,

të akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PPS nr. 91/11), datë 13 prill 2012, të paraqitur në gjykatë më 23 prill 2012, me aktin e mëposhtëm:

se nga një datë e papërcaktuar deri më 09.09.2011, në bashkë-kryerje me njëri-tjetrin dhe një person të quajtur D. P., shtetas i Republikës së Serbisë, duke vepruar si një grup i organizuar dhe i strukturuar kriminal, kontrabanduan migrantë – shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët ishin të interesuar të dilnin jashtë Kosovës në mënyrë të paligjshme; të pandehurit A. K. dhe H. M. gjetën migrantët S. Xh. dhe dy shokë të të pandehurit H. M., Xh. dhe një shok tjetër, pastaj ata i dërguan këta migrantë në vendet e Europës Perëndimore përmes territorit të Republikës së Serbisë përmes të dyshuarit D. P.; më 09.09.2011, i pandehuri I. P. gjeti tre migrantë pasi kishte rënë dakord për këtë me A. K.: Sh. G., F. Sh. dhe S. L.; pas pagesës prej së paku 1.600 eurosh për person, ata i dërguan këta tre migrantë në Gj. tek A. K., i cili, sipas marrëveshjes i dërgoi ata tek i pandehuri B. S., i cili do t'i dërgonte pastaj të tre migrantët në Fsh. S., për t'ia dorëzuar ata një personi nga Serbia, i cili do t'i dërgonte më tutje në Francë;

megjithatë, gjatë rrugës, i pandehuri B. S. dhe të tre migrantët, Sh. G., F. Sh. dhe S. L., u ndaluan nga policia dhe u dërguan në stacionin policor,

veprimet e mësipërme u klasifikuan se përbënin këto vepra penale:

krim i organizuar, në shkelje të Nenit 274 paragrafi 2 lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës,

kontrabandimi me migrantë, në shkelje të Nenit 138 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës,

pasi zhvilloi seancat e shqyrtimit gjyqësor në publik më 10 shtator, 21 dhe 22 tetor, 03 dhe 04 dhjetor 2013, në prani të:

- Prokurorit të PSRK-së Besim Kelmendi,
- të dëmtuarit F. Sh., prezent më 21 tetor 2013,
- të akuzuarit A. K. dhe mbrojtësit të tij M. M.,
- të akuzuarit I. P. dhe mbrojtësit të tij H. J.,
- të akuzuarit B. S. dhe mbrojtësit të tij E. Q.,
- të akuzuarit H. M. dhe mbrojtësit të tij H. L.

pasi u këshillua dhe votoi më 05 dhjetor 2013, në bazë të Nenit 471 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (këtej e tutje "KPP"), më 05 dhjetor 2013 shqipton në publik këtë:

AKTGJYKIM

I. A. K., I. P. dhe B. S. janë fajtorë sepse:

më 09 shtator 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, duke vepruar në bashkëkryerje me njëritjetrin, me qëllimin për të siguruar për veten e tyre përfitim pasuror, tentuan të kontrabandojnë S. L., Sh. G. dhe F. Sh., shtetas të Republikës së Kosovës, të cilët nuk ishin as banorë të përhershëm, as shtetas të Republikës së Serbisë, as të ndonjë shteti të Zonës Schengen, nga territori i Republikës së Kosovës për në territorin e Republikës së Serbisë duke organizuar për ata, kundrejt pagesës së 600 eurove, transportimin për në Republikën e Serbisë, nga ku ata do të hynin në Zonën Schengen pa vepruar në pajtueshmëri me rregullat e nevojshme për hyrje të ligjshme në këtë Zonë, dhe pastaj do t'i transportonin ata për në territorin e Republikës së Austrisë, gjë që nuk u realizua sepse S. L., Sh. G. dhe F. Sh. u ndaluan nga Policia e Kosovës para se të kalonin kufirin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe

Republikës së Serbisë, me të cilin veprim ata kryen veprën penale të kontrabandimit me migrantë në tentativë, në shkelje të Nenit 170 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe Nenit 28 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës të 20 prillit 2012 (KPRK) dhe Nenit 31 të KPRK-së,

prandaj

A. K. dënohet në bazë të Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 28 paragrafi 3 të KPRK-së për këtë veprë penale me 2 (dy) vite burgim dhe gjobë në shumën 2 000 (dy mijë) euro;

I. P. dënohet në bazë të Nenit 170 paragrafi 1, Nenit 28 paragrafi 3 dhe Nenit 76 paragrafi 1 nën-paragrafi 4 të KPRK-së për këtë veprë penale me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe gjobë në shumën 200 (dyqind) euro;

B. S. dënohet në bazë të Nenit 170 paragrafi 1 dhe Nenit 28 paragrafi 3, Nenit 75 paragrafi 1 nën-paragrafi 1 dhe Nenit 76 paragrafi 1 nën-paragrafi 4 të KPRK-së për këtë veprë penale me 1 (një) vit dhe 6 (gjashtë) muaj burgim, dhe gjobë në shumën 500 (pesëqind) euro, dhe në bazë të Nenit 51 paragrafi 2 dhe Nenit 52 paragrafi 2 të KPRK-së, dënimi me burgim i caktuar kundër B. S. nuk do të ekzekutohet në rast se ai nuk kryen asnjë veprë tjetër penale gjatë periudhës 3 (tre) vjeçare të verifikimit;

II. Në bazë të Nenit 46 paragrafi 2 të KPRK-së, afati përfundimtar për pagesën e gjobave nga të akuzuarit A. K., I. P. dhe B. S. vendoset 3 (tre) muaj;

III. Në bazë të Nenit 97 paragrafi 1 të KPRK-së

- i akuzuari A. K. detyrohet të paguajë 300 euro si shuma e parave që përputhet me përfitimin pasuror të siguruar;
- përfitimi pasuror në shumën 295 euro i sekuestruar më 09 shtator 2009 nga i akuzuari B. S., konfiskohet;
- i akuzuari A. K. detyrohet të paguajë 5 euro si shuma e parave që përputhet me përfitimin pasuror të siguruar;

IV. Të akuzuarit A. K., I. P., B. S. dhe H. M. lirohen nga akuza e kryerjes së kontrabandës me migrantët S. Xh. dhe dy shokët e të pandehurit H. M., Xh. dhe një shok tjetër, siç përshkruhet në dispozitivin e Aktakuzës, Neni 138 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës, sepse nuk u provua se ata e kishin kryer veprën që u vihej në barrë;

- V. I akuzuari H. M. lirohet nga akuza e kontrabandimit të migrantëve S. L., Sh. G. dhe F. Sh., siç përshkruhet në dispozitivin e Aktakuzës, Neni 138 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Kosovës, sepse nuk u provua se ai e kishte kryer veprën që i vihej në barrë;
- VI. Të akuzuarit A. K., I. P., B. S. dhe H. M. lirohen nga akuza e krimit të organizuar, nën Nenin 274 paragrafi 2, lidhur me Nenin 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPRK), sepse ata nuk morën pjesë aktivisht në veprimtari të kriminale dhe veprimtari të tjera të një grupi të organizuar kriminal, me dijeninë se pjesëmarrja e tyre do të ndihmonte në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi i organizuar kriminal;
- VII. Në bazë të Nenit 83 paragrafi 1 të KPRK-së, periudhat e privimit të lirisë së të pandehurve llogariten në dënimin me burgim të caktuar kundër tyre, përkatësisht nga 05 dhjetori 2011 deri më 05 mars 2012 dhe nga 08 korriku 2013 deri më 05 dhjetor 2013;
- VIII. Në bazë të Nenit 451 paragrafi 4 të KPPK-së, shpenzimet e procedurës penale do të mbulohen pjesërisht nga të akuzuarit si vijon:
- nga A. K. në shumën paushall prej 50 (pesëdhjetë) eurosh,
 - nga I. P. në shumën paushall prej 50 (pesëdhjetë) eurosh,
 - nga B. S. në shumën paushall prej 50 (pesëdhjetë) eurosh,
- IX. Shpenzimet e procedurës penale lidhur me lirimimin nga akuzat do të paguhet nga mjetet e gjykatës;
- X. Shpenzimet e mbetura të procedurës penale do të paguhet nga mjetet e gjykatës.

ARSYETIM

Historia procedurale

Aktakuza

- 1) Më 23 prill 2012 Prokurori Publik i PSRK-së paraqiti në Gjykatën Themelore të Gjilanit Aktakuzën PPS nr. 91/11 kundër të akuzuarve A. K., I. P., B. S. dhe H. M. për veprat penale të krimi të organizuar, në shkelje të Nenit 274 paragrafi 2 lidhur me Nenin 23 të KPP-së, dhe për veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, në shkelje të Nenit 138 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit të Përkohshëm Penal (më pas KPP).
- 2) Meqenëse i akuzuari A. K. ishte në arrati më 23 tetor 2012, lënda e tij u veçua nga lënda kundër të tre të pandehurve të tjerë. Kundër tij u shqiptua letër-rreshtimi ndërkombëtar.
- 3) Më 05 dhjetor 2012, gjyqtari konfirmues i Gjykatës së Qarkut Gjilan e konfirmoi Aktakuzën e mësipërme kundër të akuzuarve I. P., B. S. dhe H. M. me Aktvendimin KA Nr. 68/12. Gjatë seancës së konfirmimit, ata u vetë-deklaruan jo fajtorë. Gjyrtimi kryesor kundër tyre filloi më 06 qershor 2013. Të akuzuarit mbetën pranë qëndrimit të tyre lidhur me akuzat dhe u vetë-deklaruan jo fajtorë.
- 4) Më 7 korrik 2013, Gjykata mori informacion se i pandehuri A. K. dëshiron të vetë-dorëzohet, prandaj shqyrtimi u shty deri në një njoftim të mëvonshëm.
- 5) Më 08 korrik 2013, i akuzuari A. K. u paraqit në Gjykatë. Pastaj u caktua shqyrtimi fillestar në këtë lëndë, i cili u mbajt më 17 korrik 2013. Gjatë këtij shqyrtimi, të akuzuarit u vetë-deklaruan fajtorë për të gjitha akuzat në aktakuzë. Kryetarja e trupit gjykues nuk u bind se çështjet e parashikuara në paragrafin 1 të Nenit 248 KPP-së ishin vërtetuar, sepse vetë-deklarimi i fajësisë nuk mbështetej nga faktet e lëndës të përfshira në aktakuzë, materialet e paraqitura nga prokurori i shteti për të plotësuar aktakuzën dhe të pranuar nga të pandehurit dhe prova të tjera (Neni 248 (1.2) i KPP-së). Për këtë arsye u mor aktvendim që nuk e pranonte vetë-deklarimin e fajësisë dhe kryetarja e trupit gjykues procedoi me shqyrtimin fillestar sikur të mos ishte bërë vetë-deklarimi i fajësisë.
- 6) Mbrojtja e të akuzuarit A. K. nuk paraqiti ndonjë kundërshtim ndaj provave dhe nuk kërkoi rrëzimin e aktakuzës. Lënda kundër tij u ribashkua me lëndën e të akuzuarve I. P., B. S. dhe H. M. (Aktvendimi i datës 20 gusht 2013). Prandaj ishte e nevojshme që shqyrtimi gjyqësor të fillohej nga e para me të katër të akuzuarit.

- 7) Shqyrtimi gjyqësor kundër të katër të akuzuarve filloi më 10 shtator 2013. Të akuzuarit H. M. dhe I. P. u vetë-deklaruan jo fajtorë, i akuzuari B. S. u vetë-deklarua fajtor për akuzën e kontrabandës me migrantë, dhe A. K. u vetë-deklarua fajtor për të gjitha akuzat në aktakuzë. Gjykata gjeti se kërkesat nën Nenin 148 paragrafi 1 të KPP-së nuk ishin plotësuar prandaj vetë-deklarimi i fajësisë i A. K. nuk u pranua.

Ligji i zbatueshëm material dhe procedural

- 8) Meqenëse gjatë procedurës penale kundër të akuzuarve ligji material dhe procedural ishte objekt i ndryshimeve thelbësore, është e nevojshme të përcaktohet ligji i zbatueshëm si çështje paraprake, para se të hyjmë në meritat e lëndës.
- 9) Në pajtim me Nenin 3 (1) të Kodit Penal (më vonë KPRK), Ligji 04/L- 082 i vitit 2012 (që hyri në fuqi më 1 janar 2013), për kryerësin duhet të zbatohet ligji në fuqi në kohën që ishte kryer vepra penale. Në rast të ndonjë ndryshimi në ligjin e zbatueshëm për një lëndë, para marrjes së vendimit përfundimtar, zbatohet ligji më i favorshëm, ashtu siç parashikohet në paragrafin 2 të dispozitës së cekur.
- 10) Të akuzuarit u akuzuan me veprat penale të kontrabandës me migrantë dhe krimit të organizuar. Në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal (më pas KPP), e para dënohej me burgim në afat nga dy deri në dymbëdhjetë vjet (Neni 138 (1) i KPP), ndërsa KPRK parashikon për këtë vepër gjobë dhe burgim nga dy deri në dhjetë vjet (Neni 170 (1) i KPRK-së). Kodi i mëparshëm dhe kodi i tanishëm parashikojnë të njëjtat dënime për veprën penale të krimit të organizuar. Prandaj, në bazë të Nenit 3 (1) të KPRK-së, duhet të zbatohet ligji i ri si më i favorshëm për kryerësit.
- 11) Me Kodin e ri të Procedurës Penale ("KPP"), Ligji 04/L-123 i vitit 2012, në fuqi që më 1 janar 2013, ligji procedural u ndryshua në mënyrë thelbësore. Ndërsa në bazë të Kodit të Përkohshëm Penal të UNMIK-ut të vitit 2004 (KPPP) procedura kishte më tepër orientim nga e drejta kontinentale, kodi i ri përfshiu procedurë më kundërshtuese. Për lëndën në fjalë, çështjet thelbësore lidhur me ligjin e zbatueshëm janë nëse procedura para gjykatës (faza e aktakuzës dhe vetë-deklarimit, shqyrtimi gjyqësor dhe faza e mjeteve ligjore) do të rregullohet nga KPP apo nga KPPP. Po kështu, ka rëndësi vendimtare të përcaktohen se cilat dispozita duhet të zbatohen nga Gjykata për të vlerësuar pranueshmërinë e provave të siguruara gjatë hetimit të kryer në bazë të Kodit të mëparshëm. Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, është e nevojshme të citojmë dispozitat kalimtare të përmbajtura në Kapitullin XXXVIII të KPP-së.
- 12) Neni 541 i KPP-së deklaron kështu:

1. *Procedurat penale në të cilat është ngritur aktakuza por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi të këtij kodi, nuk do të konfirmohen sipas dispozitave të Kodit që ka qenë në fuqi në kohën e ngritjes së aktakuzës, por do të procedohen sipas dispozitave të këtij kodi.*
2. *Procedurat penale në të cilat aktakuza është konfirmuar me aktvendim të formës së prerë, para hyrjes në fuqi të këtij kodi, dhe procedurat në të cilat është ngritur propozim akuza, do të përfundohen në bazë të dispozitave të këtij kodi.*

13) Në lëndën në fjalë, aktakuza u ngrit më 23 prill 2012, një kohë kur ishte i zbatueshëm KPPP. Aktakuza ishte konfirmuar në lidhje me të akuzuarit I. P., H. M. dhe B. S. dhe ky vendim ishte bërë përfundimtar para se të hynte në fuqi Kodi i ri i Procedurës Penale. Prandaj, meqenëse janë plotësuar kërkesat e Nenit 541 (2) të KPP-së, lënda para Gjykatës është proceduar bazuar në dispozitat e ligjit të ri.

14) Lidhur me lëndën e të akuzuarit A. K., e cila ishte veçuar para konfirmimit të aktakuzës, zbatohet dispozita e Nenit 541 (1) të KPP-së. Prandaj, nuk nevojitej ndonjë procedurë konfirmimi, sepse kjo fazë procedurale u eliminua nga Kodi i ri. Në vend të kësaj, shqyrtimi fillestar u zhvillua në bazë të Neneve 26 dhe 240 e në vazhdim të KPP-së.

15) Pasi ka shqyrtuar sa u cek më lart, kryetarja e trupit gjykues mban pozicionin se procedura para Gjykatës në lëndën në fjalë duhet të zhvillohet në pajtim me dispozitat e KPP-së, ndërsa për të vlerësuar pranueshmërinë e provave të mbledhura gjatë hetimit, duhet të zbatohet Kodi i vjetër.¹ Duhet nënvizuar se gjatë hetimit të kryer sipas Kodit të mëparshëm, Prokurori nuk mund të kishte parashikuar që ligji do të bëhej objekt i ndryshimeve thelbësore dhe nuk mund të kishte parashikuar rregulla të ndryshme të zbatueshme për provat që do të paraqiteshin.

Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e trupit gjykues:

16) Në bazë të Nenit 11 (1) të *Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199)*, gjykata themelore është kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha lëndët, përveç nëse parashikohet ndryshe në ligj.

17) Veprat penale, sipas Aktakuzës, u kryen në qytetin e Gjilanit, që është në territorin e Gjykatës Themelore të Gjilanit. Prandaj, bazuar në Nenin 29 (1) të KPP-së, kjo Gjykatë ka kompetencë territoriale për të gjykuar lëndën.

18) Asnjë çështje nuk u ngrit nga palët lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

¹ Shih gjithashtu *Gjykata Themelore e Mitrovicës, Aktvendim lidhur me Aktakuzën dhe Aktvendimin për Vazhdimin e Paraburgimit, P 14/13, 12.04.13*

Shqyrtimi gjyqësor

- 19) Siç u përmend më lart, fillimisht shqyrtimi gjyqësor u fillua kundër tre të akuzuarve: I. P., H. M. dhe B. S.. Pas aktvendimit për ribashkimin e lëndës së A. K., shqyrtimi gjyqësor nisi nga fillimi kundër të katër të akuzuarve.
- 20) Shqyrtimi gjyqësor u mbajt në publik më 10 shtator, 21 dhe 22 tetor, 03 dhe 04 dhjetor 2013 në prani të Prokurorit të PSRK-së, Besim Kelmendi, të dëmtuarit F. Sh. (prezent më 21 tetor 2013), të akuzuarit A. K. dhe mbrojtësit të tij M. M., të akuzuarit I. P. dhe mbrojtësit të tij H. J., të akuzuarit B. S. dhe mbrojtësit të tij E. Q. dhe të akuzuarit H. M. dhe mbrojtësit të tij H. L..
- 21) Të dëmtuarit Sh. G. dhe S. L. u informuan me rregull për datat e shqyrtimit. Ata nuk u paraqitën në Gjykatë sepse ndodhen jashtë shtetit, sic rezultoi nga informacioni i siguruar nga Policia.
- 22) Në bazë të ligjit, përkthyesit ndërkombëtarë përkthyen në procedurën e Gjykatës dhe të gjitha dokumentet gjyqësore që kishin të bënin me shqyrtimin gjyqësor, nga anglishtja në shqipe dhe anasjelltas.

Kërkesa për zgjerimin e aktakuzës

- 23) Më 3 nëntor 2013, i pandehuri A. K. deklaroi, ndër të tjera, se ai ishte strehuar nga H. M. ndërkohë që ishte në arrati nga autoritetet. Në dritën e kësaj deklarate, Prokurori i kërkoi Gjykatës të zgjeronte Aktakuzën kundër H. M. me akuza të paspecifikuara. Ky i fundit vendosi të heshtë pas marrjes së udhëzimeve nga Gjykata dhe mbrojtësi i tij se ai mund të heshte nëse ekzistonte mundësia që ai të fajësonte vetveten.
- 24) Më 4 nëntor 2013, Gjykata vendosi ta hedhë poshtë kërkesën e Prokurorit për zgjerimin e Aktakuzës me akuza shtesë kundër H. M.. Kjo situatë rregullohet nga Neni 351 i KPPK-së, i cili shpall:
 - 1. Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen veprë penale ose nëse vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor mund të përfshijë edhe këtë veprë në bazë të akuzës së prokurorit të shtetit, e cila mund të paraqitet edhe gojarisht.*
 - 2. Në rastin e tillë, gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor për t'i dhënë kohë mbrojtjes për t'u përgatitur, e pas dëgjimit të palëve, mund të vendosë që për veprën nga paragrafi 1. i këtij neni të gjykojë veçmas të akuzuarin.*

3. Nëse për gjykimin e çështjes nga paragrafi 1. i këtij neni është kompetent departamenti tjetër në kuadër të gjykatës themelore, trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve, vendos se a do t'ia dërgojë çështjen për të cilën është duke e drejtuar shqyrtimin gjyqësor gjykatës drejtpërdrejt më të lartë kompetente për të marrë vendim.

25) Gjykata shënon se deklarata e të pandehurit A. K. që pretendon se ai u strehua në shtëpinë e të pandehurit H. M. mjafton thjesht për dyshimin e bazuar. Nuk ka prova të tjera në shkresat e lëndës që do të sugjeronin se i pandehuri H. M. e strehoi A. K. gjatë kohës që ai ishte në arrati. Prokurori ceku se ai mund të thërrasë dëshmitarë për të dëshmuar lidhur me këtë, por ai nuk i shpjegoi Gjykatës se cilët janë këta dëshmitarë ose për çfarë rrethanash do të dëshmonin ata. Prokurori nuk kishte zhvilluar asnjë intervistë paraprake lidhur me këta dëshmitarë të mundshëm. Thirrja e dikujt në gjykatë për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitarit pa dijeninë paraprake se çfarë do të deklarojë ai, është thjesht një veprim hetimor. Nuk i takon Gjykatës të hetojë vepra të mundshme penale që mund të jenë kryer sepse kjo do të minonte rëndësë rolin e Gjykatës si arbitër midis palëve të barabarta – akuzës dhe mbrojtjes.

26) Prandaj, kërkesa e prokurorit për zgjerimin e aktakuzës u hodh poshtë.

Gjetjet faktike dhe vlerësimi i provave të paraqitura

27) Akuzat e përshkruara në Aktakuzë mbulojnë dy situata kur të akuzuarit pretendohet se morën pjesë në kontrabandën me migrantë, duke vepruar si grup i organizuar dhe i strukturuar kriminal:

- nga një datë e papërcaktuar deri më 09.09.2011, të pandehurit A. K. dhe H. M. gjetën migrantë, S. Xh. dhe dy shokë të të pandehurit H. M., Xh. dhe një shok tjetër, pastaj ata i dërguan këta migrantë në vendet e Europës Perëndimore përmes territorit të Republikës së Serbisë përmes të dyshuarit D. P.;
- më 09.09.2011, i pandehuri I. P. gjeti tre migrantë pasi ra dakord për këtë me A. K.: Sh. G., F. Sh. dhe S. L.; pas pagesë së të paktën 1.600 eurove për person, ata i dërguan këta tre migrantë në Gj. tek A. K., i cili, sipas marrëveshjes, i dërgoi ata tek i pandehuri B. S., i cili më pas do t'i dërgonte të tre migrantët në Fsh. S. për t'ia dorëzuar ata një personi nga Serbia, i cili do t'i dërgonte ata më tutje në France; megjithatë, gjatë rrugës, i pandehuri B. S. dhe të tre migrantët, Sh. G., F. Sh. dhe S. L., u ndaluan nga policia dhe u dërguan në stacionin policor.

28) Lidhur me situatën e parë, Prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor paraqiti vetëm një provë për të vërtetuar se kjo kishte ndodhur. Ishte deklarata e të akuzuarit A. K. ajo që e përshkroi situatën kur ai ishte takuar me H. M., D. P. dhe dy persona të tjerë në një restorant. Aty kishte pasur një bisedë të shkurtër gjatë së cilës personat e takuar (njëri prej tyre pretendohet se ishte S. Xh.) shprehën interesin e tyre për t'u larguar nga Kosova. A. K. vetëm dëgjoi se të paktën S. Xh. e realizoi planin e tij dhe shkoi në Francë. *(deklarata e A. K. e datës 3 dhjetor 2013, f. 17-19, dhe 22 dhjetor 2011, f. 8)*

29) Nuk ka ndonjë provë tjetër se ndonjëri prej të akuzuarve u përfshi në organizimin e kalimit të kufirit nga këta njerëz. Nuk u vërtetua se me kë do të takoheshin H. M. dhe A. K.. Nuk u vërtetua nëse këta persona (përfshirë S. Xh.) u larguan nga Kosova, dhe nëse po – në çfarë rruge. Prandaj Gjykata gjen se nuk ka prova se të akuzuarit morën pjesë në organizimin e largimit nga Kosova të ndonjërit prej këtyre personave.

Lidhur me situatën e dytë të kontrabandës me migrantë të përfshirë në Aktakuzë, Gjykata vërtetoi këto fakte:

30) I. P. punonte si taksist. Në verën e vitit 2009 ai mësoi nga shoku i tij R. M. se A. K. ishte i përfshirë në organizimin e kalimit të paligjshëm të kufirit të Kosovës për në Serbi dhe mbërritjen në vendet e BE-së. Në gusht 2009, kur P. po priste në vendqëndrimin e taksive në Pejë për udhëtarë të mundshëm, ai vuri re dy burra (më vonë u mësua se ata ishin F. Sh. dhe Sh. G.), të cilët po kërkonin për ndonjë mundësi për të shkuar ilegalisht në Serbi me taksist. Ata po pyesnin për këtë të gjithë taksistët që po prisnin në vendqëndrimin e taksive. Ata iu afruan edhe I. P., i cili tha se njihte një person i cili mund ta rregullonte këtë. Pastaj ai thirri shokun e tij R. M. i cili i dha atij numrin e telefonit të A. K.. *(deklarata e I. P. e datës 3 dhjetor 2013).*

31. I. P. e ka thirrur A. K. dhe telefonin ia ka dhënë Sh. G. dhe F. Sh. të cilët ishin duke folur me K. rreth mundësisë se shkuarjes në Serbi. Ata janë pajtuar për këtë. G. dhe Sh. i kanë thënë I. P. se do të shkojnë me dy persona të tjerë e pastaj ai do të mëre të gjithë në Gj. ku A. K. do të pres për ata. Para datës 9 Shtator 2011 palët e dëmtuara janë takuar disa here me I. P. për të biseduar rreth udhëtimit për në Gj.. *(Deklarata e I. P. e datës 3 Dhjetor 2013 dhe e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013.)*

32. Me 8 Shtator 2011 P. e ka informuar G. dhe Sh. se vetëm dy nga dy ata do të udhëtojnë për në Serbi. Ai pastaj e ka thirrur A. K. dhe janë pajtuar se ai do të sjellë këtë dy burra në Gj. të nesërmen në mëngjes. Ata është dashur të takojnë A. K. rreth orës 9.00 në hyrje të qytetit nga drejtimi i F.. P. është

pajtuar për 20 Euro nga secili person për ti dërguar me veture nga P. për ne Gj.. *(deklarata e I. P. e datës 3 Dhjetor 2013.*

- 33.Me 9 Shtator 2011, Sh. G. dhe F. Sh. janë takuar me I. P. ne P. rreth orës 6 te mëngjesit dhe ai i ka dërguar ne Gj. me taksi te tij. Kur ishin duke iu afruar Gj. njeri nga palët e dëmtuara i quajtur A. K. ka biseduar me atë rreth vendit te sakte te takimit. Ata kane arritur atje rreth orës 9 te paradites dhe I. P. se bashku me palët e dëmtuara ka ardhur te A. K. i cili ka qene duke i pritur ata. Është bere një bisede e shkurtër rreth asaj se çka do te ndodhte pastaj. I. P. ka dëshiruar te sigurohej se çdo gjë do te shkonte ne rregull meqë ishte ai i cili do te rregullonte kontaktet ndërmjet palëve te dëmtuara dhe A. K.. *(deklarata e F. Sh. nga 21 Tetori 2011, deklarata e I. P. nga 3 Dhjetor 2013.)*
- 34.Ne ndërkohe personi i trete dëmtuar – S. L. ka arritur ne vendin e takimit. A. K. i ka thënë Sh. G., F. Sh. dhe S. L. ta pres atë ne hotelin K.. Ata gjithashtu kane folur rreth pagesave dhe janë pajtuar qe 200 euro ti paguajnë secili prej tyre atë dite. Pjesa tjetër (1400 euro për person) do te paguhej pas arritjes se tyre te suksesshme ne V., Austri. Pas kryerjes se kësaj marrëveshje A. K. është larguar nga ata dhe I. P. i ka lënë G. dhe Sh. te hoteli K.. S. L. gjithashtu ka shkuar atje vetëm. P. i ka lenë G. dhe Sh. ne hyrje te hotelit dhe është kthyer me veture mbrapa ne P.. Palët e dëmtuara kane qene duke pritur për A. K. ne restaurant te hotelit. *(deklarata e F. Sh.j e datës 21 Tetor 2011, deklarata e I. P. dhe A. K. nga data 3 Dhjetor 2013, deklarata e S. L. nga data 22 Dhjetor 2011, deklarata e Sh. G. nga 22 Mars 2012.)*
- 35.Ndërkohe, A. K. ka shkuar me veture te shtëpia e B. S. për ta marre atë. Ai ka pasur nevojë për ndihmën e tij ne transportimin e palëve te dëmtuara te kufiri sepse ai nuk ishte ne gjendje qe ta bënte këtë vet sepse ai e martohej pot e njëjtën dite. *(deklarata e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013, deklarata e B. S. nga data 22 Tetor 2013)*
- 36.Pas rreth 30 minutave nga takimi me palët e dëmtuara jashtë Gj. ka ardhur A. K. te hoteli K. me një Mercedes se bashku me te afërmin e tij B. S. Ai e ka marre palën e dëmtuar ne veture e pastaj ai ka ngasur veturën neper qytet për te kërkuar një taksi. *(deklarata e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013, deklarata e B. S. e datës 22 Tetor 2013, deklarata e F. Sh. e datës 21 Tetor 2011)*
- 37.A. K. i ka marre nga te dy palët e dëmtuara 600 euro, 300 euro i ka mbajtur për vete e te tjerat ai ia ka dhëne B. S. *(deklarata e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013, Procesverbal i konfiskimit te përkohshëm te gjerave te datës 9 Shtator 2011, nr. 2011-YE-436)*
38. Pas një kohe A. K. e ka gjetur një taksi me vozitësin Z. J. A. K. e ka pyetur nëse ai mund ti merrte 4 persona ne S. dhe vozitësi është pajtuar ta bënte këtë për 10 euro. Ata kane folur njeri me tjetrin

përmes dritareve te veturave te tyre meqë te dy ishin ulur Brenda. Pas kësaj bisede te shkurtër B. S., F. Sh., Sh. G. dhe S. L. kane dalë prej Mercedesit ne taksi. *(deklarata e Z. J. – 21 Tetor 2013 dhe 06 Qershor 2013, deklarata e B. S. e datës 22 Tetor 2013, deklarata e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013, deklarata e F. Sh. e datës 21 Tetor 2011, deklarata e S. L. e datës 22 Dhjetor 2011, deklarata e Sh. G. e datës 22 Mars 2012).*

39. B. S. ka marre para nga A. K. per te paguar për taksi. (10 euro) si dhe 45 euro për vete si kompensim për “rrezikun”. Pas arritjes ne S. palët e dëmtuara janë marre nga një person tjetër i cili është dashur t’ju ndihmoje atyre ne kalimin ilegal te kufirit. Për këtë person S. ka marre nga K. edhe 245 Euro *(deklarata e B. S. e datës 22 Tetor 2013, deklarata e A. K. e datës 3 Dhjetor 2013, Regjistrim mbi konfiskimin e përkohshëm te gjerave te datës 9 Shtator 2011, nr. 2011-YE-436)*

40. Gjatë rrugës për në S. vozitësi i taksisë Z. J. është ndalur nga policia. Te gjithë pasagjeret (duke e përfshirë) janë arrestuar dhe janë dërguar ne stacion te policisë. Gjate bastisjes janë konfiskuar nga B. S.. *(deklarata e Z. J. – 21 Tetor 2013 dhe 06 Qershor 2013, deklarata e B. S. e datës 22 Tetor 2013, deklarata e F. Sh. e datës 21 Tetor 2011, deklarata e S. L. e datës 22 Dhjetor 2011, deklarata e Sh. G. e datës 22 Mars 2012, Regjistrimi mbi konfiskimin e gjerave te datës 09 Shtator 2011, nr. 2011-YE-436)*

41. Disa dite me vone I. P. e ka kontaktuar familja e F. Sh. dhe Sh. G. i cili ka kërkuar nga ai ti paguaj paratë e paguara nga unë për kontrabandë. Për te zgjedhur këtë problem ai ka dashur ti ktheje gjysmës e parave (300 euro) meqë ai është ndier përgjegjës për humbje. *(deklarata e I. P. e datës 3 Dhjetor 2013).*

42. Kur vlerësohet besueshmëria e deklaratave te akuzuarit duhet te nënvizohet se ne rastin e I. P. dhe B. S. ka një tendence te qarte për te reduktuar rolin ne ngjarje me qellim te përjashtimit apo se paku për te limituar përgjegjësinë penale. Ne anën tjetër, ne lidhje me A. K. Gjykata heton se ai tregon gatishmëri për te ekzagjuar pozitën e tij dhe shkallen e aktivitetit te tij penal. Ai ka vendosur te bashkëpunojë me Prokurorin për çka ka mundur te influencoje ne deklaratën gjersa ai tenton japë sa me shume detale qe është e mundur, mundësisht jo ne kujdesin e saktësisë dhe besueshmërisë se tyre. Duhet te vërehet gjithashtu se mbrojtja nuk ka pasur mundësi te sfidoje deklaratat e dy palëve te dëmtuara Sh. G. dhe S. L. Prandaj, Gjykata duhet te bazoje zbulimin faktik kryesisht ne dëshmitë e paraqitura nga mbrojtja e cila duhet te ekzaminohet tërësisht me shtjellimin me te madhe.

43. H. M. gjate tere procedurës si pasoje ka deklaruar se ai nuk ka pasur asgjë te përbashkët me kontrabandimin e emigranteve dhe nuk ka marre pjese ne asnjë aktivitet kriminal. Ai ka pretenduar se nuk ka qene i angazhuar ne asnjë grup te organizuar kriminal (deklarata e 22 Tetor 2013). Deklaratat e

tij duhet te vlerësohen nga Gjykata sit e besueshme meqë Prokurori nuk ka prezantuar asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e tij se i akuzuari M. ka marre pjese ne aktivitetet kriminale te cilat ai akuzohet. Siç është cekur me lart e vetmja prove kundër tij ka qene një deklaratë gjenerale e A. K. e cila nuk është përputhur me asnjë dëshmi tjetër. Duhet gjithashtu te thuhet se gjate shqyrtimit kryesor A. K. e ka pranuar se H. M. nuk ka pasur asgjë te beje me kontabandimin e emigranteve te datës 09 Shtator 2011.

44. Deklaratat e te akuzuarit A. K., I. P. dhe B. S. Gjykata i sheh sit e besueshme ne prizmin se ato korrespondojnë me njëra tjetrën dhe mbështeten me dëshmi tjera te besueshme te mbledhura gjate procedurës.

45. Analizat e deklaratave te këtyre tre te akuzuarave qon ne përfundimin se versioni me i sakte dhe me i vërtetë është prezantuar nga secili prej tyre gjate ekzaminimit te tyre gjate shqyrtimit kryesor. Te tre personat e akuzuar i kane prezantuar detalet e tregimit te ngjarjes qe kane ndodhur me 09 Shtator 2011 dhe këtyre qe drejtpërdrejt kane sjellë tek ato. Versioni i prezantuar nga ata gjate shqyrtimit kryesor janë koherente me njëra tjetrën dhe ne shtese mbështeten me dëshmi tjera te mbledhura gjate procedurës.

46. Ne lidhje me deklaratat e I. P. Gjykata nuk ka besuar se ai nuk ka pasur dijeni se ne çfarë aktivitete ka marre pjese ai. Ne te vërtetë, kjo është vetëm një deklaratë qe qëndron ne kontradiktë jo vetëm me dëshmitë tjera te prezantuara gjate procedurës por gjithashtu me rrëfimet e ardhshme te mu te akuzuarave. Qe nga fillimi ai e ka ditur se palët e dëmtuara kane shikuar për mundësinë te dalin nga Kosova ilegalisht, ai i ka kontaktuar ata me një person qe i ka pasur mundësitë e tilla (A. K.), ai është takuar disa here me palët e dëmtuara për ti diskutuar detalet. Me tutje, me 09 Shtator 2011 ai jo vetëm qe i ka sjellë ata ne Gj. por gjithashtu ka qene prezent ne bisedën ndërmjet atyre dhe A. K.. Kur nuk ka pasur sukses i tere operacioni për shkak te intervenimit te policisë ai është ndier përgjegjës ndaj tyre dhe ka dashur te paguaj mbrapa se paku një pjese te parave. Nëse ai e kishte luajtur rolin vetëm te taksistit te zgjedhur rastësisht nga palët e dëmtuara ai nuk do ta angazhonte veten aq thelle ne këtë shtate dhe roli i tij do te kufizohej vetëm ne vozitjen e tyre nga P. ne Gj..

47. Deklaratat e I. P. mbështeten nga A. K. i cili gjate deklaratës te dhënë me pare ne Gjykate ka konfirmuar se ka qene ai për te luajtur rolin kryesor ne rregullimin e kalimit ilegal te kufirit nga tre persona me 09 Shtator 2011. K. gjithashtu ka pranuar se ai i ka paguar nga ata 600 euro dhe te tjerat është dashur te paguhen pas arritjes se tyre ne V.

48. Meqë Gjykata e ka pare se deklaratat e te akuzuarit I.P. dhe A. K. sit e besueshme, te dhëna gjate shqyrtimit kryesor, deklarata e dëshmitarit F. Sh. është vlerësuar si pjesërisht e rrejshme. Definitivisht nuk është e vërtetë se ai është takuar me I. P. vetëm rastësisht me 09 Shtator 2011 sepse i akuzuari vet e ka pranuar se ka qene ne kontakt me palët e dëmtuara me pare dhe ka qene ai i cili i ka kontaktuar ata me A. K..
49. Me tutje, nuk ka dëshmi te mjaftueshme për te vërtetuar se I. P. ka marre nga palët e dëmtuara para tjera përveç shumes prej 20 euro për person te paguara për dërgimin me veture nga P. ne Gj. Zbulime te tilla nuk mbështeten nga dëshmitari tjetër F. Sh. i cili para Gjykatës ka thënë se ka paguar vetëm 200 euro A. K. dhe te tjerat është dashur te paguhen pas arritjes se suksesshme ne V.. Ne këtë mënyrë ai është tërhequr nga deklarata e mëparshme te dhënë para Prokurorit gjate hetimeve. A. K. gjithashtu ka qene konsekuent ne këtë çështje meqë gjate tere procedurës ai ka deklaruar se ai ka qene i vetmi qe ka marre para për “shërbimet” për kontrabandimin e emigranteve.
50. Ne lidhje me këtë element Gjykata gjithashtu i ka konsideruar dëshmitë e dy palëve tjera te dëmtuara: Sh. G. dhe S. L.. Nuk ka qene e mundur te ekzaminohen ata drejtpërdrejtë para Gjykeses sepse qe te dy e kane lëshuar Kosoven dhe nuk dihet vendbanimi aktual i tyre. Prandaj, Gjykata e ka përdorur mundësinë siç ceket ne nenin 338 paragrafi 1 te KPK qe lejon ne suate te tilla te lexohen deklaratat e mëparshme te dëshmitareve. Megjithatë, ato duhet te vlerësohen tërësisht dhe nuk mund te përdoren si dëshmi e drejtpërdrejtë për te bere zbulime faktike. Këto pjesë te dëshmive mbështetin zbulimet qe palët e dëmtuara kane dashur te dalin nga Kosova ilegalisht dhe për këtë qellim ata kane vepruar me asistencën e I. P. dhe A. K.. Ata gjithashtu kane konfirmuar faktin se arrestimit nga policia para kalimit te kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë se bashku me taksistin Z. J. dhe te akuzuarin B. S..
51. Dëshmia e Sh. G. nuk mund te trajtohet si prove për zbulimin se I. P. i ka marre 1000 euro nga ai dhe nga F. Sh.. Kjo deklarate qëndron ne kontradiktë me dëshminë e F. S. dhe deklaratat e I. P. dhe A. K..
52. Pas krahasimit te përpiktë te deklaratave te dhëna nga A. K. dhe I. P. te mbështetura nga dëshmitë e dëshmitarit F. Sh. gjate shqyrtimit kryesor dhe pjesët e mbetura te dëshmisë qe janë treguar me lart, Gjykata ka ardhur ne përfundim se ne lidhje me elementet esencial e te gjitha këto dëshmi e kane vërtetuar dhe konfirmuar njëra tjetrën. Te gjithë këta persona ne mënyrë konsistente kane deklaruar se ne këtë faze te kontrabandimit, secila pale e dëmtuara ka paguar 200 euro për A. K., dhe paratë tjera është dashur te paguhen pas arritjes ne V., A.. A. K. ka qene konsistent se ka qene ai i cili ka marre para, e njëjta është deklaruar nga F. Sh. dhe I. P.. Ne shtese, ky zbulim vërtetohet me sjelljen e

I. P. i cili ka dashur t'ju ktheje gjysmën e këtyre parave palëve te dëmtuara (300 euro) sepse ai është ndier përgjegjës për këtë humbje.

53. Fakti se paratë e vetme për kontrabandë i janë paguar A. K. i cili gjysmën e tyre ia ka dhënë B. S. që është vërtetuar nga rezultatet e kërkimit të kësaj të fundit e cila u krye pasi që taksia ishte ndaluar nga policia në rrugën për S.. Shuma 295 € është gjetur dhe sekuestruar më pas. Nuk ka justifikim tjetër pse B. S. mund të ketë pasur sasi aq të madhe parash me vete në këtë kohë.

54. Gjykata vlerësoi deklaratat e B. S. si të besueshme në lidhje me pjesëmarrjen e tij në kontrabandimin e emigrantëve më 9 shtator 2011. Nuk ka dyshim se ishte i vetëdijshëm se në çfarë vepre ishte duke marrë pjesë pasi që ai e pranoi se kishte për të marrë nga A. K. një shumë të caktuar parash për "rrezik" siç ai e përshkroi atë. Ai e dinte se aktivitetet e tij ishin të paligjshme, dhe detyra e tij ishte që të sjellë palët e dëmtuara në S. ku ai kishte për ti pasuar ata tek një person tjetër.

55. Nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se B. S. është angazhuar në kontrabandimin e emigrantëve më shpesh se në këtë, një herë. Nga deklarata e A. K. dhënë në shqyrtimin kryesor rezulton se ai e ka përdorur atë vetëm një herë në këtë situatë më 9 shtator 2011 për shkak se ai vet nuk ishte në gjendje të marr pjesë në të.

56. Gjykata gjeti deklaratat e dëshmitarit Z. J. si të besueshme dhe të sinqerta. Ai ka përshkruar në një mënyrë të qëndrueshme se çfarë ka ndodhur më 9 shtator 2011, sidomos rrethanat në të cilat ai ka rënë dakord se do të dërgojë katër persona në S. . Gjatë marrjes në pyetje në gjykatë dëshmitari konfirmoi faktet e paraqitura në deklaratën e tij dhënë prokurorit publik. Gjykata ka marrë parasysh se dëshmia e dëshmitarit ishte qartësisht e qëndrueshme në lidhje me faktet e paraqitura më lart. Mospërputhjet e vogla në deklaratën e tij më parë do t'i atribuoheshin kohës që kishte kaluar që nga ngjarjet të cilat janë objekt i këtij gjykimi . Në fakt, pika e vetme e dobët e kësaj deklaratë të dëshmitarit "është mohim i tij i qëndrueshëm për të rënë dakord me A. K. rreth rrjedhës për S. Dëshmitari konfirmoi se përveç katër njerëzve që kanë udhëtuar me të, ishte edhe një shofer i një Mercedesi, por ai nuk e njohu atë si A. K. Kjo deklaratë qëndron në kundërshtim me mu deklaratën e të akuzuarit K. dhe të dëshmitarëve të tjerë. Gjykata mendon se Z. J. thjesht mund të ketë harruar fytyrën e personit nga Mercedesi, gjë që është shumë e kuptueshme pasi që ai e ka pa atë vetëm për disa minuta dhe nuk kishte asnjë arsye të përqendronte vëmendjen në të.

57. Nuk ka pasur arsye për të dyshuar besueshmërinë e Procesverbalin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 9 shtator 2011, nr. 2011- YE - 436 dhe Raportin për ekzaminimin mjeko- ligjor 511-01-115/1-10240/09VN të datës 16 dhjetor 2009. Gjykata ka vlerësuar si të besueshme Raportin e

Policisë së 9 shtatorit 2011 nr. 2011-YE-436, por natyrisht vetëm si dëshmi se informacioni i paraqitur në raport është marrë dhe regjistruar nga policia dhe jo si provë e vërtetësisë së vetë informacionit.

Klasifikimi ligjorë i veprimit të të akuzuarit

58. Vlerësimi i provave në lidhje me elementin e parë të akuzës kundër të akuzuarit (kontrabandë të një grupi të emigrantëve me S. Xh. para 9 shtator 2011) çoi në përfundimin se të gjithë të akuzuarit nuk ishin fajtor për këtë veprim. Nuk ka prova të mjaftueshme se ndonjë nga personat e përmendur nga prokurori në aktakuzë ishin kontrabanduar në mënyrë të paligjshme përtej kufirit të Kosovës për kudo vend tjetër. Prokurori nuk ka paraqitur dëshmi se vepra penale ishte kryer. Prandaj të gjithë të akuzuarit janë liruar nga kjo akuzë.
59. Gjykata arriti në përfundimin se A. K., I. P. dhe B. S. kanë kryer veprën penale të tentim kontrabandimit të emigrantëve në bazë të nenit 170, paragrafi 1 i KPRK dhe nenin 28 paragrafi 1 dhe 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosova më 20 Prill 2012 (KPRK) dhe nenit 31 të KPRK. Ajo është themeluar që nga 9 shtator 2011, në territorin e Republikës së Kosovës, duke vepruar në bashkë kryerje me njëri-tjetrin, me qëllim të përfitimit material për veten e tyre ata kanë tentuar për të kontrabanduar S. L., Sh. G. dhe F. Sh., shtetas të Republika së Kosovës, të cilët as nuk ishin banorë të përhershëm apo shtetas të Republikës së Serbisë e as të asnjë shteti të Zonës Shengen , nga territori i Republikës së Kosovës në territorin e Republikës së Serbisë duke rregulluar pagesën prej 600 Euro për transport në Republikën e Serbisë, nga ku ata do të kishin hyrë në zonën Shengen pa vepruar në përputhje me kërkesat e nevojshme për hyrjen e ligjshme në këtë zonë dhe pastaj të transportohen në territorin e Republikës së Austrisë. Ky qëllim nuk u realizua për shkak se S. L., Sh. G. dhe F. Sh. u ndaluan nga Policia e Kosovës para se të kalonin kufirin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë . Neni 170 (4) të KPRK parashikon se një tentim për të kryer vepër penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e dënueshme .
60. Kjo duhet të konsiderohet deri në nivelin e të qenit të sigurt se tre të akuzuarit kanë vepruar në bashkëpunim, pasi ata të gjithë ishin të vetëdijshëm se do të marrin pjesë në kontrabandimin e emigrantëve përtej kufirit të Kosovës. Secili prej tyre kishte për të marrë një përfitim material të këtij aktiviteti të përbashkët. Ata ekzekutuar një plan të pranuar bashkërisht dhe për këtë arsye se ata së bashku kanë kryer krimin i cili është një esencë e bashkëkryerjes së përshkruar në nenin 23 të KPRK.
61. Nuk ka dëshmi se H. M. pjesë në kontrabandimin e emigrantëve në 9 shtator 2011 , pra, i vetmi vendim që do të merret është shfajësimi .

62. Të akuzuarit ishin akuzuar edhe për veprën e krimit të organizuar në shkelje të nenit 274 (pa specifikuar një paragraf) të KPRK i cili përcakton si vijon::

- 1 *Kushdo që kryen një krim të rëndë si pjesë e një grupi të organizuar kriminal dënohet me gjobë deri në 250.000 EUR dhe me burgim prej së paku shtatë vjet.*
- 2 *Kushdo që merr pjesë aktive në aktivitete kriminale apo të tjera të një grupi të organizuar kriminal, duke e ditur se pjesëmarrja e tij ose e saj do të kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda nga grupi i organizuar kriminal, do të dënohet me burgim së paku pesë vjet.*
- 3 *Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyrë, udhëheq apo drejton aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal dënohet me një gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.*

63. Përkufizimi i nevojshëm ligjor për të përcaktuar elementet e veprës penale të krimit të organizuar janë të përfshira në paragrafin 7 të këtij neni i cili thotë si në vijim:

Për qëllime të këtij neni,

- 1) *Shprehja "krim i organizuar" do të thotë krim i rëndë i kryer nga një grup i strukturuar për të përfituar drejtpërsëdrejti ose tërthorazi dobi pasurore ose financiare.*
- 2) *Shprehja "grup i organizuar kriminal" do të thotë një grup i strukturuar ekzistues për një periudhë kohore dhe që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda për të përfituar, drejtpërdrejtë ose tërthorazi dobi pasurore ose financiare .*
- 3) *Shprehja "krim i rëndë" do të thotë një vepër penale e dënueshme me burgim prej së paku katër vjet.*
- 4) *Shprehja "grup i strukturuar" do të thotë grup prej tre ose më shumë personave që nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një veprë penale dhe është e nevojshme të ketë përcaktuar zyrtarisht rolet e anëtarëve të vet, vazhdimësinë e anëtarësisë ose të strukturës së zhvilluar.*

64. Vepra penale e krimit të organizuar kërkon kryerjen e një shkelje "themelore" përveç veprës penale të krimit të organizuar nga neni 274 të KPRK. Formulimi i përdorur në të gjithë nenin 274 të KPRK në mënyrë të qartë përcakton se kryerja e një veprë themelore është një element themelor në këtë

vepër. Përndryshe, një individ mund të shpallet fajtor për të njëjtën vepër, pjesë përbërëse e të dy veprave penale, të krimit të organizuar dhe të veprës themelore.²

65. Në lidhje me veprën penale të krimit të organizuar, Kodi i ri Penal nuk është më i favorshëm për të pandehurit se sa Kodi i Përkohshëm Penal. Prandaj në përputhje me parimin e përcaktuar në nenin 3 (1) të KP do të aplikohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

66. Gjykata konsideroi akuzën e krimit të organizuar në lidhje me të akuzuarit A. K., I. P. dhe B. S. sepse vetëm në rast të tyre është konstatuar se krimi themelor (Kontrabandimi i emigrantëve) është kryer. Analiza e provave të paraqitura gjatë gjykimit nuk çon në përfundimin se i akuzuari ka vepruar si grup i strukturuar ekzistues për një periudhë kohore të caktuar dhe në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një ose më shumë krimeve të rënda në mënyrë që të përfitojë drejtpërdrejt ose tërthorazi, një përfitim financiar ose përfitime tjera materiale. Nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se aktivitetet e tre të akuzuarve në 9 shtator 2011 të mos kenë qenë formuar rastësisht. Siç rezulton nga provat e marra i akuzuari I. P. nuk e kishte njohur A. K. më parë, ata kontaktuan vetëm në këtë rast, kur P. ka shikuar për të ndihmuar një person për të kaluar kufirin midis Kosovës dhe Serbisë ilegalisht. Përveç kësaj, B. S. është angazhuar në të gjithë aksionin në momentin e fundit dhe vetëm për shkak se A. K. nuk ishte në gjendje ai vet të shoqërojë emigrantët për shkak të dasmës. Nuk ka prova se B. S. është e angazhuar në mënyrë të përhershme në aktivitetet lidhur me kontrabandimin e emigrantëve. Ka edhe ca logjikë në deklaratat e A. K., i cili tha se në qoftë se ai do të kishte udhëtuar me emigrantët nuk do të kishte asnjë fare rast pasi ai do të kishte ditur se çka ti thoshte policisë, ndërsa B. S. nuk kishte asnjë ide se si të fliste me ta. Duhet theksuar se policia i ndaloi ata, gjersa ata ende ishin në taksin e aksidental, në territorin e Kosovës, kështu që do duhej të ishte mjaft e lehtë për ta, për të shpjeguar se pse ata po udhëtonin për të S. . Fakti që ata nuk ishin në gjendje të bëjnë këtë, forcon konkludimin se B. S. ishte së bashku në këtë situatë në fund të fundit pa ndonjë njohuri të veçantë se si ai do të duhej të sillej.

Caktimi i Dënimit

67. Ndërsa bëhet caktimi i dënimit për A. K., I. P. dhe B. S., Gjykata ka qenë e detyruar të marrë parasysh qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 41 të KPRK i cili i përcakton ato si më poshtë:

- Të parandalojë kryerësin nga kryerja e një e veprave penale në të ardhmen dhe të rehabilitoj kryerësin;

² Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 61/2012, vendim i datës 2 tetor 2012

- Të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale,,
- Të ofrojë kompensim të viktimave apo të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga sjellje kriminale; dhe
- Të shprehë të drejtën e shoqërisë për vepra penale, të rrisë moralin dhe të forcojë obligimin për respektimin e ligjit..

68. Në rastin e një personi i cili ka tentuar të kryejë vepër penale, ai ose ajo duhet të ndëshkohet sikur ai ose ajo ka kryer veprën penale, megjithatë, dënimi mund të reduktohet (neni 28 (3) të KPRK). Në raste të tilla, gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të vogël të dënimit (neni 75 (1.1) të KPRK). Kufijtë mbi zbutjen e dënimeve janë të përcaktuara në nenin 76 të KPRK. Në përputhje me paragrafin 1.4 të tij, nëse një periudhë prej dy (2) vjet është paraparë si masë e ulët e burgimit për një vepër penale (si në nenin 170 (1) të KPRK), dënimi mund të zbutet deri në burgim deri në gjashtë (6) muaj.

69. Ndërsa bëhet caktimi i dënimit Gjkata ka konsideruar të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, në pajtim me nenin 74 paragrafi (1) të KPRK.

70. Gjkata ka konsideruar faktorët rëndues si vijon:

- Sa i përket A. K. - një shkallë e lartë e pjesëmarrjes së tij në veprën penale si ai ishte personi kryesor përgjegjës për kontrabandimin e emigrantëve më 9 shtator 2011;
- Sa i përket A. K. dhe I. P. - një shkallë të lartë të qëllimit për të kryer veprën penale;
 - Sa i përket të gjithë të akuzuarve - faktin se vepra penale e kontrabandimit të emigrantëve duket të është kryer shpesh në Kosovë në ditët e sotme. Kjo ndikon rëndë në rendin publik, prandaj dënimi për këtë lloj të krimin duhet të shërbejë si një pengesë e përgjithshme për të gjithë kryerësit e mundshëm;
- Sa i përket të akuzuarit I. P., fakti se ai tashmë ishte i dënuar për vepër penale (informacion ky nga Gjkata Themelore e Pejës nga 02 dhjetor 2013).

71. Gjkata ka marrë parasysh faktorët lehtësues si në vijim:

- Sa i përket të gjithë të akuzuarve- bashkëpunimit të përgjithshëm - në procedurën penale,
- Sa i përket A. K. – pendim i treguar;
- Sa i përket B. S. - roli i tij i vogël në veprën penale pasi ai nuk ishte autori kryesor;

- Sa i përket B. S. -moshë e re, fakti se ai ende ka një mundësi për të vazhduar shkollimin dhe nuk ka dënime penale të mëparshme;
- Sa i përket I. P. -fakt se ai është një njeri familjar, me 10 fëmijë, duke fituar vet për jetesë të familjes së tij.

72. Duke marrë parasysh si më sipër, Gjykata ka ngarkuar të pandehurit me dënimet e mëposhtme:

- A. K. - 2 (dy) vjet burgim dhe një gjobë në shumë prej 2 000 Euro (dy mijë);
- I. P. - 1 (një vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe me gjobë në shumën prej 200 Euro (dyqind);
- B. S. - 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim dhe një gjobë në shumë prej 500 euro (pesëqind).

73. Në rast të I. P. dhe B. S. Gjykata e përdorur mundësinë e dhënë në nenin 28 (3) të KPRK dhe ka reduktuar dënimin duke zbatuar rregullat e përcaktuara nga Kodi.

74. Përveç kësaj, në bazë të nenit 51 paragrafi 2 dhe neni 52 paragrafi 2 i KPRK, Gjykata vendosi se dënimi me burgim të shqiptuar kundër B. S. nuk do të ekzekutohet në qoftë se ai nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale për periudhën e verifikimit prej 3 (tre) vjetësh. Gjykata beson se një vërejtje me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme për të parandaluar B. S. në kryerjen e veprës penale

75. Në bazë të nenit 97 Paragrafi 1 të KPRK

- I akuzuari A. K. është i obliguar të paguajë 300 euro si një shumë parash që i korrespondon dobisë pasurore të fituar nga ai;
- Përfitimi material prej 295 euro të sekuestruara më 9 shtator 2009 nga të akuzuarit B. S. konfiskohen;
- I akuzuari A. K. është i detyruar të paguajë 5 euro si një shumë parash që i korrespondon dobisë pasurore të fituar pasi që kjo shume parash nuk është konfiskuar gjatë kontrollit të B. S..

76. Në bazë të nenit 83, paragrafi 1 i KPRK është detyrë e Gjykatës të kreditojë periudhën kohore që i akuzuari e kaluar në paraburgim shtëpiak përkundër dënimit me burgim i cili iu është ngarkuar atij. Kjo lloj mase është zbatuar vetëm kundër A. K., përkatësisht nga 5 dhjetor 2011 deri në 5 mars 2012 dhe nga 8 korrik 2013 deri më 5 dhjetor 2013 dhe këto periudha janë llogaritur në dënim.

Shpenzimet

77. Gjykata e mbështeti vendimin e saj mbi shpenzimet e procedurës penale në dispozitat ligjore të cituara në dispozitiv.

Përgatitur në Gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar. Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar me datë 3 janar 2014

Kryetarja e Trupit Gjykses,

Anna Adamska – Gallant

Christine Sengl, Procesmbajtëse

Përkthimi i Aktgjykimit prej Gjuhës angleze në Gjuhën shqipe:

Kastriot Myftiu,

Zeqir Shabani

Mjeti Ligjor:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë më formë të shkruar kundër këtij Aktgjykimi nëpërmjet Gjykatës Themelore në Gjilan për Gjykatën e Apelit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e dorëzimit të kopjes së Aktgjykimit, sipas Nenit 380 par. 1 i KPP.